



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.62/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.01.2011, nga LDK-ja në të cilën theksohet se “në QV 3008A në Drenoc të Malishevës janë vërejtur parregullsi pasi nga mëngjesi kane qëndruar një numër i madh i vëzhguesve të PDK-ës për të cilët dyshohet se disa prej tyre nuk janë certifikuar. Ata kane qëndruar në korridor duke ju ofruar votuesve që të shkojnë për të votuar. Gjithashtu në këtë qendër të votimit është vërejtur një numër i personave të cilët qëndrojnë në oborr dhe në brendi të shkollës si dhe në forme indirekte bëjnë presion tek votuesit e Drenocit. Kryetari i shtabit zgjedhor të LDK-ës në Malishevë ka kërkuar nga kryesuesi i i KKZ-ës Rexhep Zogaj që ti jepet lista e vëzhguesve të PDK-ës të akredituar për zgjedhjet e 9 janarit 2011, por ky i fundit nuk ka qene në gjendje të ofroje një liste të tilla. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës në VV nr 02 deri në orë 10:30 min kane qëndruar tre vëzhgues të PDK-ës, gjithashtu në këtë qendër votimi ka qëndruar edhe Xhevat Krasniqi vëllai i kandidatit për deputet nga radhët e PDK-ës Halit Krasniqi. Sipas parashtruesit të ankesës edhe pse Xhevati është me profesion polic në vendvotim ka qëndruar me rroba civile. Edhe menaxheri i kësaj QV Alush Krasniqi ka lejuar njerëz të paautorizuar për të qëndruar brenda në qendër. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e shefit të shtabit zgjedhor të LDK-ës në Malisheve, Hamez Shala.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar. PZAP vlerëson se në baze të informacionit të paraqitur në ankese nuk mund të konstatohet se ka pasur parregullsi të procesit të votimit në VV përkatës. Për më tepër, parashtruesi i ankesës nuk ka sqaruar se sa ka qenë kohëzgjatja e qëndrimit të supozuar të vëzhguesve të PDK-se në korridor të QV-se dhe i personave të cilët kanë qëndruar në oborr të VV-se, si dhe cili ka qenë niveli i ndikimit të mundshëm të tyre në procesin e votimit dhe në çfarë mënyre është ushtruar presion tek votuesit. Po ashtu edhe pse sipas pretendimeve të parashtruesit ka qenë e pamundur të posedohej lista e vëzhguesve të akredituar, parashtruesi ka pasur mundësi që të mund të identifikonte emrat e vëzhguesve të PDK-se dhe këtë informacion t'ja ofronte PZAP, me qëllim që PZAP të verifikonte akreditimin e tyre. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 62/2011 më datën 13.01.2011.

